

ABSTRAKTI

Heshtja administrative paraqitet si një dukuri e organeve të administratës, të cilat, jo në çdo rast, tregohen të përgjegjshme dhe efikase në kryerjen e detyrave, funksioneve dhe kompetencave të tyre. Kjo sjellje shpesh përfshin neglizhimin e zgjidhjes së çështjeve administrative, për të cilat ato janë kompetente dhe të autorizuar nga ligji.

Një dukuri e tillë sjell pasiguri tek qytetarët dhe bizneset, duke i lënë ata pa përgjigje për çështjet juridiko-administrative që kërkojnë zgjidhje dhe veprim nga organet e administratës. Në përgjigje të kësaj dukurie negative, e cila ndikon në uljen e përgjegjësisë dhe efikasitetit të administratës publike, sistemet juridike kanë krijuar institutin e heshtjes administrative, duke i dhënë të drejtën dhe mundësinë palës që të marrë një zgjidhje juridike për çështjen e saj, pavarësisht nga mosveprimi apo heshtja e administratës.

Ky institut i së drejtës administrative, varësisht nga sistemi juridik apo edhe çështja administrative mund të rezultojë me një akt fiktiv administrativ, i cili nxirret pasi administrata hesht dhe e pajisë palën me vërtetim mbi aprovimin apo refuzimin e kërkesës, varësisht nëse sistemi juridik për çështjen administrative konkrete parashikon heshtjen administrative pozitive apo negative.

Si i tillë, instituti i heshtjes administrative ka një rëndësi të madhe në rritjen e përgjegjësisë dhe efikasitetit të administratës publike, duke e nxitur atë të veprojë në kohë dhe të japë përgjigje për çështjet administrative. Në të kundërtën, ex lege (sipas ligjit) do të jepet një përgjigje për palën, pavarësisht nga veprimi i administratës.

Fjalë kyçe: *Heshtje administrative, institut administrativ, akt administrativ, mosveprim, përgjegjësi, efikasitet.*